Avokat Yll Zekaj
Prishtinë, Rrustem Statovci,
Hyrja 34/1, Nr.1
Republika e Kosovës
Tel: +383(0)44 375 730

Me anë të kësaj shkresë **GOE "100% DESIGN SHPK** përfaqësuar nga Avni Lushtaku Drejtor **dhe TERMOMONTIMI** e përfaqësuar nga z. Skender Mecinaj – Drejtor", me vullnet të plotë, të vetëdijshëm për efektet e:

A U T O R I Z O N

Avokat Yll Zekaj, me numër të licencës 2226/22, me seli të zyrës në rrugën "Rrustem Statovci", Hyrja 34/1, nr.1, Prishtinë.

Avokati autorizohet që të përfaqësoj interesat e **GOE "100% DESIGN SHPK dhe TERMOMONTIMI",** në Aktivitetin e Prokurimit: Nr i prokurimit207-22-10084-5-2-1 Nr i brendshëm 207-22-075-5-2-1 ne të gjitha çështjen juridike, që janë duke u zhvilluar në Autoritetin kontraktues, Organin Shqyrtues te Prokurimit, eventualisht në Gjykata dhe procedurat tjera sipas nevojës.

I autorizuari i ka të gjitha autorizimet pa kufizime të cilat i takojnë sipas ligjit, përkatësisht të parashtrojnë mjete juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme, të tërhiqen nga to pjesërisht apo në tërësi, të arrijnë marrëveshje gjyqësore dhe jashtëgjyqësore, të paraqesin propozime dhe kërkesa, si dhe të pranojnë të gjitha parashtresat, njoftimet, lajmërimet dhe shkresat, aktgjykimet dhe aktvendimet për dhe në emrin tonë.

I autorizuari me këtë autorizim, ka të drejtë të përfaqësoj **GOE "100% DESIGN SHPK dhe TERMOMONTIMI"**, pranë çdo institucioni apo organi tjetër, në të gjitha procedurat administrative, gjyqësore dhe procedurat tjera në zhvillim per aktivitetin e prokurimit të cituar me lart. Ky autorizim mund ta bartë të personat e tjerë, varësisht vlerësimit profesional nga marrësi i këtij autorizimi.

Autorizim jepet për kohë të pa caktuar dhe vlen deri në revokimin e autorizimit nga ana ime.

Prishtinë:
Datë: 06 Mars 2023

Dhënës i autorizimit:

GOE "100% DESIGN SHPK dhe TERMOMONTIMI"

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i prokurimit	**207-22-10084-5-2-1**
Nr i brendshëm	**207-22-075-5-2-1**

Sa i përket tenderit për:

Lagja e Hajdineve në Terizaj - Gjilan

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

Emri i Kompanisë: **GOE *"100% DESIGN SHPK & TERMOMONTIMI"***

Adresa: **Prekaz i Poshtëm 41000, SKENDERAJ**

Numri Telefonit/ Numri i Faks-it: 044/502-270

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: **Avni Lushtaku**

Adresa elektronike: **prokurimi100design@gmail.com**

Data e parashtrimit të ankesës: 10.03.2023 **Nënshkrimi dhe vula:** _____

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Yll Zekaj
(Emri i avokatit)

Rr. Rrustem Statovci 34/1, nr.1 Prishtinë
(Adresa e plotë)

044/375-730
(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

yll.zekaj@gmail.com
(Adresa elektronike)

10/03/2023
(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

AVOKAT - LAWYER
Yll Zekaj - SH.P.K.
Nr.L: 2226/22-Prishtinë

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë "apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- **Njoftimi për kontratë: 21.09.2022**
- **Dosja e tenderit e datës: 21.09.2022**
- **Procesverbali i hapes i datës, 07.10.2022**
- **Njoftimi mbi Vendimin e AK datë: 14.10.2022**
- **Kërkesa e parë për Rishqyrtim 18.10.2022**
- **Shkrese e AK për kthimin e aktivitetit në rivlerësim: 25.10.2022**
- **Shkresa e AK per vazhdimin e vlefshmërisë se tenderëve: 09.02.2023**
- **Njoftimi mbi Vendimin e AK datë: 22.02.2023**
- **Kërkesa e dytë për Rishqyrtim 27.02.2023**
- **Njoftimi i dytë për vendimin e AK-së pas kërkesës për rishqyrtim i datës 02.03.2023**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*
A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Nuk aplikohet

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

Nuk aplikohet

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Me datën 27.02.2023 përmes platformës se e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim te Autoriteti Kontraktues – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Me datë 02.03.2023 kemi pranuar vendimin për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e dispozitave te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092:

- Neni 24 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës- Barazia para ligjit;

- Neni 47 i LIGJI Nr. 05/L -068 LPP për plotësim ndryshimin e nenit 72 par.1 të LIGJIT Nr. 04/L-042 LPP Dokumentacioni dhe informacioni shtesë;

- Neni 1 i LPP Nr. 04/L-042 Qëllimi;

- Neni 2 i LPP Nr. 04/L-042 Fushëveprimi;

- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

- Neni 7 i LPP Nr. 04/L-042 Barazia në Trajtim/Jo-diskriminimi;

- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

- Neni 60 Kriteret për dhënien e kontratës

- Neni 66 Përshtatshmëria profesionale

- Pika 1 par. 1.4 e RRUOP - Fushëveprimi i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ

- Pika 39 e RRUOP Sqarimi i tenderit.

- Pika 60 e RRUOP F03 "Rregullat për parashtrim të ankesave".

- **Neni 31.2 i Rregullores 001/2022**

- **Neni 102 dhe 103 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik**

*** Sipas Nenit 118të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. Zhvillimi i aktiviteteve të Prokurimit nga ana e Autoriteti Kontraktues (MKRS)

1. Autoriteti Kontraktues (MKRS), me datë 14.10.2022, ka nxjerrë Njoftim mbi Vendimin e AK, për aktivitetin e prokurimit nr.207-22-10084-5-2-1, përmes të cilit njoftim/vendim ka shpërblyer me kontratë OE LIMITPROJECT SH.P.K me vlerën e ofertës prej **409.643,96 EUR** dhe ka eliminuar GOE "N.N 100% Design sh.p.k & TERMOMONTIMI me vlerën e ofertës prej **369.101,58 EUR**, për realizimin e aktiviteti i prokurimit me numër të prokurimit 207-22-10084-5-2-1. Vendim i AK është bazuar në nenin 43.7 dhe nenin 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ të Prokurimit publik.

2. GOE "N.N 100% Design sh.p.k & TERMOMONTIMI me datë 18.10.2022 ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të AK të datës 14.10.2022.

3. AK me shkresën e datës 25.10.2022, ka njoftuar palët se *"Aktivitetit i prokurimit për tenderin Lagja e Hajdineve në Terizaj - Gjilan me numër të prokurimit 207-22-10084-5-2-1dhe numër të brendshëm 207-22-075-5-2-1, kthehet ne rivlerësim, si rezultat i kërkesës për rishqyrtim nga një Operator Ekonomik dhe disa nga pretendimet e tyre kanë qenë të bazuara. Si sqarim, OE i cili ka ngritur kërkesë për rishqyrtim e ka pranuar vendimin, me sqarime detale për secilin pretendim të ngritur brenda afateve te caktuara kohore me LPP"*

4. Me 01.11.2022 hynë në fuqi Rregullorja 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje Rregullorja) ku me nenin 102 të kësaj rregulloreje shfuqizohen: 1. **A01 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik - i datës 01.02.2021**, 2. Udhëzimi Administrativ Nr. 1/2019, 3. B57 Rregullat për tenderët Jo-Normalisht të ulet, 4. **F03 Rregullat për parashtrimin e ankesave**, 5. Rregullore Nr. 2/2017 për procedurat e dhënies dhe revokimit të certifikatës profesionale | prokurimin publik, 6. B59 Rregullat për Shërbime të veçanta (Konsulentët/Kontraktohet individual) (18.11.2020).

5. AK me shkresën e datës 05.12.2022 ka kërkuar nga OE LIMITPROJECT SH.P.K kurse me shkresën e datës 08.12.2022 ka kërkuar nga GOE "N.N 100% Design sh.p.k & TERMOMONTIMI, plotësim të dokumentacionit.

6. AK me shkresën e datës 09.02.2023 ka kërkuar *"Nga ju kërkohet që të zgjatni vlefshmërinë e ofertave 30 ditë kalendarike duke filluar nga data 10.02.2023. deri me 11.03.2023. Afati i fundit për konfirmimin e zgjatjes së vlefshmërisë së ofertave është 10.02.2023."*

7. AK, me datë 22.02.2023, pas rivlerësimit ka nxjerrë Njoftim mbi Vendimin e AK, për aktivitetin e prokurimit nr.207-22-10084-5-2-1, përmes të cilit njoftim/vendim ka shpërblyer serish me kontratë OE LIMITPROJECT SH.P.K me vlerën e ofertës prej **409.643,96 EUR** dhe ka eliminuar GOE "N.N 100%

Design sh.p.k & TERMOMONTIMI me vlerën e ofertës prej **369.101,58 EUR**, për realizimin e aktiviteti i prokurimit me numër të prokurimit 207-22-10084-5-2-1. Vendim i AK eshte bazuar në nenin 43.7 dhe nenin 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ të Prokurimit publik.

8. GOE "N.N 100% Design sh.p.k & TERMOMONTIMI me datë 27.02.2023 ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të AK të datës 22.02.2023.

9. AK me datën 02.03.2023 merr Vendim mbi shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim me të cilën refuzon kërkesën për rishqyrtim te GOE "N.N 100% Design sh.p.k & TERMOMONTIMI dhe lënë në fuqi vendimin e datës 22.02.2023.

II. SHKELJET e AK në procesin e realizimit te aktiviteteve e prokurimit nr.207-22-10084-5-2-1

10. Njoftimi/Vendimi i AK për shpalljen e OE te suksesshme i datës 14.10.2022, shkresën e AK e datës 25.10.2022 per kthimin e aktivitetit të prokurimit në rivlerësim, kërkesat e AK për plotësimin/sqarimin e dokumentacionit nga ana e OE, shkresa e AK e datës 09.02.2023 për zgjatjen e vl*efshmërisë së ofertave,* me Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 22.02.2023 dhe Vendim mbi shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim i datës 02.03.2023 janë në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Kosovës, dispozitat e LPP, dispozitat e RUOPP dhe dispozitat e Rregullores Nr.001/2022 të Prokurimit Publik, të cilat në asnjë rrethanë nuk kanë të bëjnë me gjendjen faktike. Me poshtë do të paraqitjen shkeljet nga ana e AK gjatë realizimit te aktivitetit të prokurimit:

11. Shkresa e AK e datës 25.10.2022, me të cilën *kthehet ne rivlerësim Aktivitetit i prokurimit* është **në Kundërshtim me Pika 60 e RRUOP F03 "Rregullat për parashtrim të ankesave" dhe nenin 8 të *Rregullave për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesa.***

11.1 AK me shkresën e datës 25.10.2022, ka njoftuar palët se *"Aktivitetit i prokurimit për tenderin Lagja e Hajdineve në Terizaj - Gjilan me numër të prokurimit 207-22-10084-5-2-1dhe numër të brendshëm 207-22-075-5-2-1, kthehet ne rivlerësim, si rezultat i kërkesës për rishqyrtim nga një Operator Ekonomik dhe disa nga pretendimet e tyre kanë qenë të bazuara."*. Me tutje AK ne shkresën e datës 25.10.2022 theksojnë se *"Si sqarim, OE i cili ka ngritur kërkesë për rishqyrtim e ka pranuar vendimin, me sqarime detale për secilin pretendim të ngritur brenda afateve te caktuara kohore me LPP."*

11..2 Pika 60 e RRUOP "Ankesat" përcakton se "Referoju rregullave të aprovuara nga KRPP, të publikuara ne webfaqen e KRPP-se, F03 "Rregullat për parashtrim të ankesave". Kurse ***Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave*** *përcakton:*

Neni 8
Vendimi i Autoritetit Kontraktues

8.1 Autoriteti kontraktues, **respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit,** mund, me anë të një vendimi:

8.1.2 **të miratojë** një kërkesë për rishikim si të bazuar dhe të anulojë pjesërisht ose tërësisht vendimin e miratuar.

i. Kurdo qe miratimi i kërkesës ndërlidhet me vendimin **për shpërblim te një kontrate, Autoriteti Kontraktues, do te beje publikimin e anulimit te Njoftimit për dhënie te kontratës, duke përdorur formularin B11, dhe do te vazhdoj me ri-vlerësim te aktivitetit te prokurimit.**

11.3 Pra, pas aprovimit te pretendimeve për shkelje nga ana e OE fitues te shpallur me Njoftimi/Vendimi i AK për shpalljen e OE te suksesshme i datës 14.10.2022, AK me anë të shkresën e datës 25.10.2022 ka anuluar njoftimin për dhënie tw kontratës. Anulimi është realizuar ne kundërshtim me nenin 8 te cituar me lartë e cila përcakton se pas miratimit të kërkesës për rishqyrtim AK anulon njoftimin për dhënie te kontratës me vendim, i cili duhet te publikohet duke përdorur formularin B11, dhe te vazhdoj me rivlerësimin e prokurimit. AK nuk ka nxjerre vendim per anulim, nje vendim i tillë nuk ekziston as në dosjen online te prokurimit. Gjithashtu pretendimet ne paragrafin e dyte te shkresës se AK te datës 25.10.2022 *"Si sqarim, OE i cili ka ngritur kërkesë për rishqyrtim e ka pranuar vendimin, me sqarime detale për secilin pretendim të ngritur brenda afateve te caktuara kohore me LPP.", janë te paqëndrueshme,* pasi qe OE asnjëherë nuk eshte njoftuar me nje vendim te tillë. Me këtë përpiluesi i shkresës, Drejtori i Prokurimit Egzon Zariqi ka bere deklarate te rrejshme e cila ka elemente te veprës penale të mashtrimit

12. Kërkesa e AK e datës 09.02.2023 për zgjatje te validitetit të tenderëve (pa zgjatje te sigurimit te tenderit) **është në kundërshtim me nenin 31.2, 31.4, 102 dhe 103 të Rregullores.**

12.1 Sipas njoftimit të AK data e fundit e dorëzimit të tenderëve për aktivitetin e prokurimit **nr.207-22-10084-5-2-1 ka qene data 07.10.2022.**

12.2 AK me shkresën e datës 09.02.2023, e "në pajtueshmëri me Nenin 30.4 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ të Prokurimit" ka kërkuar na OE zgjatjen e validitetit te ofertave duke theksuar *"Nga ju kërkohet që të zgjatni vlefshmërinë e ofertave 30 ditë kalendarike duke filluar nga data 10.02.2023. deri me 11.03.2023. Afati i fundit për konfirmimin e zgjatjes së vlefshmërisë së ofertave është 10.02.2023."*

12.3 Sipas nenit 31.2 te Rregullave dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik, kërkesa për periudhë të validitetit të tenderit do të jetë në minimum 90 ditë për kontrata me vlerë të madhe. **Në dosjen e tenderit AK ka përcaktuar qe vlefshmëria e tenderit të jetë 60 ditë**. Sipas nenit 31.4 "Nën situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe **duhet të kërkohet para datës së skadimit** (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)".

12.4 Ne rastin konkret, AK ka kërkuar nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve pas 122 ditëve e qe sipas neni 31.4 të RROUP "nën situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen" të cilat mund te jene kur ka shume ofertueses e qe ne rastin konkret kane qene vetëm dy ofertues, "Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe **duhet të kërkohet para datës së skadimit".**

12.5 AK ka kërkuar zgjatjen e validitetit ne kundërshtim me nenin 31.2 dhe 31.4 dhe atë mbi dy muaj pas datës se skadimit të validitetit.

12.6 AK me kërkesën për zgjatjen e validitetit te tenderëve ka rene ndesh edhe me nenin 30.5 të RROUP i cili përcakton se në rast të kërkesës për zgjatjen e validitetit të tenderit "Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët **do të kërkohet që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre**.". AK me shkesën e datës 09.02.2023 ka kërkuar vetëm zgjatjen e validitetit te tenderit por jo edhe te sigurimit të tenderit, dhe si e tilla vazhdimi i aktiviteteve te prokurimit **pa sigurimin e tenderit** me nenin 30.5 të Rregullores dhe dispozitat e LPP.

12.7 Shkresa e AK e datës **09.02.2023** për vazhdimin e validitetit bazohet ne dispozitat e RROUP, derisa RROUP **është shfuqizuar me 1.11.2022** nga Rregullorja 001/2022 për Prokurimin Publik.

13. **Vendimi/njoftimi për shpalljen e OE të suksesshme është në Kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjit të LPP sa i përket trajtimit të barabarte të OE dhe atë si në vijim:**

Nenin 24 par.1 i Kushtetutës përcakton se "Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim", kurse neni 7 par.1 i LPP përcakton se **"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente."**
AK ka vepruar **në kundërshtim me nenin 24 te Kushtetutës dhe nenin 7 te LPP,** pasi që ne si OE, nuk jemi trajtuar të barabartë para ligjit ne raport me OE fitues. AK nuk ka përdorur standarde të njëjta në mes te OE në vlerësimin e kushteve dhe kritereve të plotësuara. AK nuk ka përdorur kritere të njëjta ne vlerësimin e Raportit të riskut, komunikimin me OE për sqarimet e nevojshme ne procesin e prokurimit. Përmes këtij trajtimi te pabarabartë dhe jemi diskriminuar nga AK, ne raport me OE fituese te aktivitet te prokurimit nr. **207-22-10084-5-2-1**.

Plotësim: *Meqenëse jemi duke deponuar Ankesë në OSHP në aspektin e shkeljeve të drejtave themelore dhe sigurisë Juridike, ne e ftojmë dhe mirëkuptojmë Ekspertin që ta trajtoj në tërësi këtë lëndë sa i perket trajtimit te pabarabart nga ana e AK dhe elementeve diskriminuese ndaj OE te eliminuar ne favor te OE fitues konform dispozitave te Kushtetutës se Kosovës dhe LPP..*

Vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit është
në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik Nr. 04/L-042

dhe atë si në vijim:

Në kundërshtim me nenin 1, pasi që AK (MKRS) ka vepruar në kundërshtim me qëllimin e këtij ligji, pasi procedura e prokurimit, gjegjësisht ky aktivitet i prokurimit, ka filluar pas një planifikimi të bërë, e që konform nenit 1, të këtij ligji, zyrtarët përgjegjës, që kanë udhëheqë me këtë aktivitet të prokurimit, është dashur që të sigurojnë efikasitet, transparencë, integritet dhe përgjegjësi, dhe se çdo veprim i këtyre zyrtarëve të mos ndikohen nga interesat personale, me jo-diskriminim, me shkallë të lartë të transparencës, në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Ne rastin tonë zyrtari përgjegjës i prokurimit, ka anuluar aktivitetin e prokurimit me shkrese dhe jo me vendim te arysetuar, duke deklaruar fakte te paqena qe OE qe ka parashturar kerkese per rishqyrtim ka pranuar vendimin, ka favorizuar OE fituese duke lejuar zëvendësimin e dokumentacionit gjatë fazës se prokurimit, kurse ka diskriminuar GOE tonë duke mos e trajtuar ne menyre te barabarte.

Në kundërshtim me nenin 2, pasi që ky nen përcakton qartë se gjatë ushtrimit të të gjitha aktivitetet e prokurimit, autoritetet kontraktuese dhe koncensionerët janë të obliguar që të zbatojnë dhe respektojnë kërkesat procedurale dhe përmbajtjesorë të këtij ligji dhe jo ne mënyrë diskriminuese te trajtohet OE nga ana e AK në favor të OE fitues.

Në kundërshtim me nenin 47 për plotësim ndryshimin e nenit 72, OSHP për ta konfirmuar faktin e trajtimit të pabarabarte mjafton qe të shikohen shkresat e AK për dokumentacionin shtese dhe sqarime. Ne këtë faze te procedurës AK ka luajtur rolin e avokatit te OE fituese kurse GOE jonë është diskriminuar për faktin se OE fitues i janë kërkuar ne detaje dokument shkrese dhe sqarime, duke filluar nga Licenca e skaduar e kompanisë Mineral LLC e cila pas sygjerimeve te AK ne shkresën për dokumentacion shtese zëvendësohet nga OE fituese me licence te re te operatorit tjetër ekonomik, gjithashtu AK i kërkon dhe mundëson OE fituese plotësime te detajuara te dokumentacionit për stafin duke përfshire aknes kontratat, CV etj. Kurse te GOE jone, kemi plotësuar te gjitha kërkesat e AK te parashtruara me shkresën per plotësimin e dokumenteve, kurse jemi eliminuar për dokumente qe fare nuk janë kërkuar te sqarohen ose plotësohen si referenca e Xhavit Jasiqit

(për të cilin me shkresën e plotësimit te dokumentacionit AK ka kërkuar vetëm aneks kontrata dhe jo edhe referenca)

14. Arsyet e eliminimit të GOE-së nga ana e AK janë të pabazuara

AK ka ofruar disa arsye për shkak te mos përmbushjes se te cilave është eleminuar GOE. Këto pretendime janë ofruar ne njoftim/vendim e AK si dhe ne vendimin në kërkesën për rishqyrtim. Këto pretendime ti trajtojmë në vazhdimësi

14.1 Vendimi në kërkesën për rishqyrtim - Arsyeja e parë (1): GOE është eliminuar ne përputhje me LPP-ne dhe duke e specifikuar do detaj në Njoftimin mbi vendimin e AK, ku thekson se: Është plotësuar stafi me disa teknik të ndërtimtarisë Nuredin Reshani dhe Arian Cakiqi të cilët nuk janë në Listën e stafit te paraqitur nga kompania gate ofertimit baze ne listën e përgatitur, edhe ne këtë rast GOE ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 te LPP-se, duke ndryshuar faktet dhe argumentet gjate paraqitjes se dokumenteve shtese. Kjo është e papranueshme nga ana e AK pasi qe specifikisht theksohet në nenin 59 se provat dhe argumentet nuk mund te ndryshon me plotësimin e dokumentacionit. Po ashtu ky plotësim nuk është kërkuar nga AK.

14.2 Sqarimi i OE në arsyen e parë (1): Pretendimi i AK nuk qëndron pasi qe OE nuk ka ndryshuar faktet qe bien ne kundërshtim me nenin 59 dhe 72 te LPP por vetëm ka ofruar ne dispozicion staf shtesë mbi kërkesat e AK (Nuredin Reshani dhe Arian Cakiqi). AK ka ofruar qysh ne fazën e ofertimit listën e stafit e cila tejkalon kërkesat e AK edhe pa 2 personat shtese për te cilët pa te drejt AK ka konsideruar qe janë ndryshim i fakteve. Për stafin e paraqitur në oferte për te cilët AK ka konsideruar qe nuk i plotësojnë kriteret si Teknik te ndërtimtarisë, te Mentor Hamza përveç certifikatave kemi dorëzuar dhe diplomat e tyre te cilët kane kualifikime te Bachelor i Ndërtimtarisë, kritere mbi ato te përcaktuara nga AK. Kurse te Astrit Islami si teknik te ndërtimtarisë e kemi paraqitur edhe ne ofertën e pare edhe ne dokumentacionin shtese, ndërsa Qëndrim Morina nuk e kemi propozuar si teknik i ndërtimtarisë por si mjeshtër i drurit i cili plotëson kriteret ne baze te certifikatave te cilat i posedon.

Kështu qe kjo arsye e pare për te eliminuar OE është e paqëndrueshme.

14.3 Vendimi në kërkesën për rishqyrtim - Arsyeja e dytë (2): MARRËVESHJE ME NTP "ARMIRI" MBI SHITËBLERJEN E MAKINAVE: 1. Bager tipi O&K i përdorur me goma dëshmia dokumentare fatura na NTP "ARMIRI" pa vërtetim të pagesës. 2. Bager tipi 1401 i përdorur me goma dëshmia dokumentare fatura nga NTP "ARMIRI" pa vërtetim të pagesës. 3. Bager tipi HITACHI HD-146 i përdorur me Zinxhirë dëshmia dokumentare fatura nga NTP "ARMIRI" pa vërtetim të pagesës. 4. Kamion - kiper me kran peshe minimale se paku 4T dëshmia dokumentare - kamioni me regjistrim 01-160-BS - libreza me regjistrim te skaduar (30.05.2020). 5. Një gjenerator me Marrëveshje me PAPENBURG&ADRIANI COMPANY me DUD valid, kurse Një gjenerator me fature shitje nga "Amadeus Group" ku blerësi është "100% Design" por pa vërtetim te pagesës. 6. Aparat Saldues - me fature shitje nga "Power Plus" SHPK ku blerësi është "TERMOMONTIMI" por pa vërtetim të pagesës.

14.4 Sqarimi i OE në arsyen e dytë (2): Marrëveshja me NTP " ARMIRI" mbi shitblerjen e makinave- janë kontrata te blerjes ne vitin 2009 – 2010, për te cilat ne kemi ofruar kontratat dhe faturat ndërsa sipas dosjes se tenderit vërtetimet e pagesave janë kërkuar vetëm nga artikulli 4 e deri ne 10. Një gjenerator me fature shitjeje nga Amadeus group e vitit 2006, do duhej ta plotësonte kriterin e kërkuar nga AK meqenëse e kemi faturën dhe ne kohen kur e kemi blere nuk ka qene obligative transferi bankar sipas ATK-se, dhe ne si OE çdo vit i paraqesim ne ATK amortizimin e këtyre pajisjeve te cilat i kemi dëshmitë e dorëzimit pranë ATK.

Kështu qe kjo arsye e dytë për të eliminuar OE është e paqëndrueshme.

14.5 Vendimi në kërkesën për rishqyrtim - Arsyeja e tretë (3): GOE pas kërkesës për plotësim te dokumentacionit ka ndryshuar faktet dhe të dhënat. Si rasti ne vijim: i njëjti GOE në aplikimin baze ka ofruar dëshmi lidhur me kërkesën: 7. Gypa për largimin e interneve ne punishte, PROFATURE te lëshuar AKTIV shpk, ndërsa njëjti GOE ne plotësimin e dokumentacionit me date 12. 12.2022 paraqet një fature nga Vëllezërit Shala SHPK duke shfrytëzuar dhe argumentuar fotografinë e njëjtë te gypave që e ka te paraqitur ne aplikimin baze.

14.6 Sqarimi i OE në arsyen e tretë (2): Ne ofertën baze kemi dorëzuar fotografinë e gypave ne teren nga TERMOMONTIMI qe është pjesë e GOE sonë, (faturën dhe dëshminë e pagesës e kemi dorëzuar pas kërkesës për plotësim të dokumentacionit). Ndërsa pro faturën nga 100% DESIGN, profature të cilën do e paguanim menjëherë me pranimin e mallit, meqenëse kompania "AKTIV" është vonuar me dorëzimin e mallit dhe ka dhënë informacion te operatori tjeter lidhur me profaturen ne mënyrë jozyrtare, ne kemi vendosur qe ato gypa mos ti marrim nga AKTIV por nga një kompani tjetër.

Kështu qe kjo arsye e dytë për të eliminuar OE është e paqëndrueshme.

14.7 Vendimi në kërkesën për rishqyrtim - Arsyeja e katërt (4):

Grup i Operatorëve Ekonomik N.N. 100 % Design Sh.p.k.; TERMOMONTIMI, Prekazi i Poshtëm, 41000, Skenderaj, Kosove nuk ka arritur te plotësoi kriterin ashtu siç është kërkuar nga AK-MKRS, pasi qe e njëjta ka bashkangjitur raportin e hartuar nga NMA SHPK për kompaninë 100% Design (e cila nuk është Lider ne Konzorcium) po ashtu është paraqitur edhe raporti HSK për liderin e kompanisë ku bazuar në vlerësimin nga komisioni vlerësues është vërejtur se ky raporti i paraqitur është me afat të skaduar (2vite nga data e lëshimit, i njëjti ishte valid deri me date 30.06.2022).

14.8 Sqarimi i OE në arsyen se katërt (4): Ashtu siç e kemi potencuar edhe ne kërkesën për rishqyrtim OE ne kuadër te GOE 100% Design ka certifikatën e vlerësimit te riskut te lëshuar me date 05.10.2022 me vlefshmëri dy vjeçare dhe konform LPP nenit 71.4 "çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 te LPP do te aplikohet ndaj grupit ne tërësi", gjithashtu edhe nga parimet e formimit te GOE për aplikim ne aktivitetet e prokurimit është bashkimi i kapitalit dhe resureve,

Kështu qe kjo arsye e dytë për të eliminuar OE është e paqëndrueshme.

Pra asnjëra nga arsyet e dhëna nga ana e AK në Njoftim/Vendim dhe Vendimin për rishqyrtim për eliminimin e GOE 100% Design Shpk & TERMOMONTIMI nuk qëndrojnë.

15. Shkeljet e AK në raport me shpërblimin me kontratë të OE - LIMITPROJECT SH.P.K

AK ka shpërblyer me kontrate OE LIMITPROJECT SH.P.K me ofertën ne vlerën prej **409.643,96 EUR** dhe ka eliminuar GOE NN 100% Design Shpk & TERMOMONTIMI me ofertën prej **369.101,58 EUR**, përkatësisht **me oferte me të ulte prej 40.542,38 euro**.

15.1 Raporti i riskut i OE fitues është i skaduar. AK nuk e ka vlerësuar raportin e riskut te OE fitues e cila është e skaduar. Vlerësimi i riskut nga ana e OE fitues është përgatitur me 18.09.2020 nga ana e Kompanisë BLITERM, kjo shihet nga "Raporti i vlerësimit të riskut ne vendin e punës". Sipas nenit 18 të Rregullores 02/21 të datës 24/02/2021 për vlerësimin e riskut ne vendin e punës përcakton se "Dokumenti i vlerësimit te riskut ne vendin e punës i lëshuar para hyrjes në fuqi te kësaj rregulloreje është valid për një (1) vit. Ne vijim, duhet te behet vlerësimi riskut në vendin as punës dhe të përgatitet dokumentacioni në përputhje me këtë Rregullore". Kjo do të thotë qe "Raporti i vlerësimit të riskut ne vendin e punës" te OE fitues ka skaduar një vit pas hyrjes në fuqi te Rregullores përkatësisht me

24/02/2022. OE ka ofruar "Raporti i vlerësimit të riskut ne vendin e punës", siç kërkohet nga AK dhe ne Rregulloren 02/21 të datës 24/02/2021 për vlerësimin e riskut ne vendin e punës, por ka paraqitur vetëm një te ashtuquajtur "Deklarate për përfundimin e Rivlerësimit të riskut" dhe kjo në mënyrë të kundërligjshme i ka mjaftuar AK qe ta vlerësoj OE fituese qe ka përmbushur kërkesën për ta prezantuar "Raportin valid të vlerësimit të riskut ne vendin e punës". Se ky raport është i pavlefshëm ka konstatuar edhe OSHP me vendimin nr.699/22 të datës 14.02.2023.

16. Papërgjegjshmërinë e operatorit te rekomanduar për kontratë, e kemi arsyetuar me prova ne kërkesën e pare për rishqyrtim te cilën e kemi dorëzuar me datën 18.10.2022, dhe ne baze të pretendimeve të arsyetuara me atë kërkesë është kthyer aktiviteti ne rivlerësim përmes "shkresës se AK" ku kemi ofruar prova te mjaftueshme për papërgjegjshmërinë e tyre. Pra vazhdojmë të qëndrojmë prapa pretendimeve te ngritura ne kërkesën për rishqyrtim te datës 18.10.2022.

17. **Gjithashtu shkeljet nga ana e AK ne procesin e aktivitetit te prokurimit si:** Kthimin e aktivitetit të prokurimit pa vendim vetëm me shkresë, tejkalimin e validitetit të tenderëve nga 60 ditë e përcaktuar ne dosjen e tenderit, ne 122 dite deri në paraqitjen e kërkesën nga AK për vazhdimin e validitetit të tenderit (kërkesë e cila duhet te parashtrohet para skadimit te validitetit), vazhdimin e validitetit te ofertave pa kërkesën për sigurimin e tenderit, trajtimin e pabarabartë të OE në proces janë bazë e mjaftueshme për OSHP që të anulohet aktiviteti i prokurimit i zhvilluar nga AK.

17. <u>Kërkesa e GOE *"100% DESIGN SHPK & TERMOMONTIMI"*</u>

Duke u bazuar në deklarimet si më lartë, në provat dhe faktet e pakontestueshme, se të gjithë OE i eliminuar ka përmbushur te gjitha kërkesat e AK konform LPP dhe KOURP kurse OE fitues ka dështuar qe në përputhje me LPP KOURP dhe ligjet e tjera relevante te përmbush kërkesat e AK, OE i eliminuar si parashtrues i kësaj ankese i propozojmë OSHP-së, që pas shqyrtimit të provave të paraqitura në këtë ankesë, si dhe në mbështetje të plotë në LPP-në dhe Rregulloren 001/2022 për Prokurimin Publik, të nxjerrë këtë:

VENDIM

I. APROVOHET, ankesa e **<u>e GOE *"100% DESIGN SHPK & TERMOMONTIMI"*</u>**në tërësi si e bazuar.
II. ANULOHET njoftimi i AK, MKRS, për shpalljen e OE LIMITPROJEKT SHPK si OE e suksesshme nw aktivitetin e prokurimit *Lagja e Hajdineve në Terizaj - Gjilan me numër të prokurimit 207-22-10084-5-2-1.*
III. OBLIGOHET AK (MKRS) që të bëjë rivlerësimin e tenderit duke pasur për bazë konstatimet nga raportet e ekspertëve si dhe vendimin e OSHP-së, përmes një komisioni vlerësues profesional, i cili do të rivlerësoj tenderin dhe të shpallë fitues **GOE *"100% DESIGN" SHPK & "TERMOMONTIMI"***.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet e shkaktuara me rastin e Sigurimeve të tenderit për shkak te shkeljeve dhe zvarritjeve të panevojshme të procedurës nga ana e AK. Shpenzime gjatë përgatitjes së Kërkesave për Ri-shqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues dhe Ankesës në Organin Shqyrtues të Prokurimit si dhe humbjeve të fitimeve të planifikuara.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

- **Njoftimi për kontratë: 21.09.2022**
- **Dosja e tenderit e datës: 21.09.2022**
- **Procesverbali i hapes i datës, 07.10.2022**
- **Njoftimi mbi Vendimin e AK datë: 14.10.2022**
- **Kërkesa e parë për Rishqyrtim 18.10.2022**
- **Shkrese e AK për kthimin e aktivitetit në rivlerësim: 25.10.2022**
- **Shkrese e AK për plotësim te dokumentacionit për OE Limit: 05.12.2022**
- **Shkrese e AK për plotësim te dokumentacionit për GOE 100%Design&Termomontimi: 08.12.2022**
- **Shkresa e AK për vazhdimin e vlefshmërisë se tenderëve: 09.02.2023**
- **Njoftimi mbi Vendimin e AK datë: 22.02.2023**
- **Kërkesa e dytë për Rishqyrtim 27.02.2023**
- **Njoftimi i dytë për vendimin e AK-së pas kërkesës për rishqyrtim i datës 02.03.2023**

****Sipas Nenit 111.2 të LPP,Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*